



**REPUBLIKA E KOSOVËS /  
REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO**

---

**C.nr.793/06**

**GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN**, gjyqtari Arsim Hamzaj, me sekretaren juridike Majlinda Shala, në kontestin e paditësit K.R."Hidroregjioni Jugor" - Prizren, kundër të paditurit S.K nga Prizreni, të cilin me autorizim e përfaqëson av. E.R nga Prizreni, për shkak të borxhit, vlera e kontestit 376.02 euro, pas mbajtjes së shqyrtimit kryesor, me datën 25.03.2014, mori këtë:

**A K T G J Y K I M**

**I. APROVOHET në tërësi kërkesëpadia** e paditësit K.R."Hidroregjioni Jugor" - Prizren dhe **obligohet** i padituri S.K nga Prizreni, që paditësit në emër të borxhit t'ia paguajë shumën e të hollave në vlerë prej **376.02** euro.

**II. Obligohet** i padituri që shumën nga pika **I** e dispozitivit të këtij aktgjykimi si dhe shpenzimet procedurale në lartësi prej **25 euro**, t'ia paguajë paditësit në afat prej 7 ditësh pas ditës së pranimit të këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përbarimit me dhunë.

**A r s y e t i m**

Tani paditësi (ish kreditori) K.R."Hidroregjioni Jugor" - Prizren, me datën 28.03.2006, pranë kësaj gjykate ka parashtruar propozim për përbarim në bazë të dokumentit autentik, kundër tani të paditurit (ish debitorit) S.K nga Prizreni, për shkak të pagesës së borxhit. Me datën 04.04.2006, gjykata ka marr aktvendimin E.nr.275/06, për caktimin e përbarimit të propozuar.

Kundër Aktvendimit për përbarim E.nr.275/06, të datës 04.04.2006, i padituri (ish debitor) S.K kishte parashtruar kundërshtim, duke e atakuar të njëjtin për shkak se nuk e ka shpenzuar ujin në shumë të cilën e kërkon kreditori dhe nuk është cekur periudha kohore prej cilës datë është shpenzuar uji, dhe për shkak të vjetërsimit-parashkrimit të kërkesës, me propozim që kundërshtimi i tij të aprovohet dhe që aktvendimi i atakuar të lihet jashtë fuqie, si dhe duke propozuar pezullimin e ekzekutimit të caktuar me aktvendimin e Gjykatës Komunale në Prizren E.nr.275/06, të datës 04.04.2006.

Duke vendosur sipas kundërshtimit të të paditurit (ish debitorit), me datën 18.10.2006, kjo gjykatë në procedurë përmbarimore ka marrë konkluzion përmes të cilit është shfuqizuar aktvendimi për lejim të përmbarimit E.nr.275/06, i datës 04.04.2006, ndërsa që propozimi për egzekutim i kreditorit, është konsideruar padë.

Procedura në këtë rast është zhvilluar në zbatim të neneve 484 dhe 485 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), që kanë të bëjnë me procedurën me kontestet me vlerë të vogël.

Në seancën e shqyrtimit kryesor, e autorizuar e paditësit S.G ka deklaruar se mbetet në tërësi pranë padisë dhe kërkespadië, duke kërkuar nga gjykata që kërkespadië e paditësit ta aprovojë në tërësi si të bazuar dhe ta obligoj të paditurin që në emër të borgjit, t'ia paguaj paditësit shumën në lartësi prej 372,02 eurove si dhe shpenzimet e procedurës, në shumë prej 25 eurove.

Në seancën e shqyrtimit kryesor, i autorizuari i të paditurit av. E.R nga Prizreni, e ka kundërshtuar kërkespadië e paditësit, pasi që nga provat e administruara shihet se shuma e fundit e borxhit është e datës 30.11.2004 ndërsa padia është parashtruar me datë 28.03.2006 që do të thotë se borxhi është parashkruar edhe pse në shkresat të cilat i ka parashtruar vet paditësja shihet se i padituri e ka likuiduar në tërësi borxhin, andaj dhe ka propozuar refuzimin e kërkespadië si të pa bazë. Shpenzimet e procedurës i ka kërkuar në shumën prej 135 euro për një përfaqësim.

Për vërtetimin e drejtë të gjendjes faktike gjykata ka administruar provat e propozuara si në vijim: Faturën me nr. 0160038, të lëshuar nga Hidroregjioni Jugor për periudhën 01.08.2005 deri më 30.09.2005: Aktvendimin e Bordit për Ankesa të Komunës së Prizrenit të datës 20.05.2013: Vendimin e Hidroregjionit Jugor të datës 18.01.2013: Procesverbalin e datës 16.01.2013 të Hidroregjionit Jugor-Prizren si dhe kartelën e klientit S.K të datës 25.03.2014 të lëshuar nga Hidroregjioni Jugor-Prizren.

Gjykata pas vlerësimit të pohimeve të palëve (palës) ndërgjyqëse dhe provave të lartcekura, në kuptim të nenit 8 të LPK-së, me kujdes dhe me ndërgjegje ka çmuar çdo provë veç e veç dhe të gjitha ato së bashku dhe ka gjetur se :

Kërkespadië e paditësit është e **bazuar**.

Nga leximi i faturës me nr. 0160038, të lëshuar nga Hidroregjioni Jugor për periudhën 01.08.2005 deri më 30.09.2005, gjykata ka konstatuar se kjo faturë është lëshuar në emër të S.K ( këtu të paditurit) dhe se sipas kësaj fature, ky borxh del të jetë në shumën prej 376.02 euro.

Nga leximi i Aktvendimit të Bordit për Ankesa të Komunës së Prizrenit të datës 20.05.2013, gjykata ka konstatuar se, me të njëjtin është aprovuar ankesa e S.K ( këtu të paditurit) dhe objekti i tij i cili ka qenë komercial është ndryshuar në objekt të braktisur.

Nga leximi i Vendimit të Hidroregjionit Jugor të datës 18.01.2013, gjykat ka konstatuar se me të njëjtin është aprovuar kërkesa e S.K ( këtu të paditurit) dhe është pasivizuar shifra me nr.0026920.

Nga leximi i Procesverbalit të datës 16.01.2013 të Hidroregjionit Jugor-Prizren, gjykata ka konstatuar se gjatë inspektimit të komisionit të Hidroregjionit Jugor tek

konsumatori S.K kanë konstatuar se i njëjti është çkyqur nga rrjeti i ujësjellësit dhe kanë propozuar që të bëhet pasivizimi i konsumatorit.

Nga leximi i kartelës së klientit S.K të datës 25.03.2014 të lëshuar nga Hidroregjioni Jugor-Prizren, gjykata ka konstatuar se borxhi i të paditurit ndaj paditësit deri më datën e ngritjes së padisë është 376.02 euro, ndërsa pas ngritjes së padisë i padituri në tërësi ka bërë pagesën e borxhit ndaj paditësit.

Me nenin 17 Ligjit mbi Marrëdhëniet e Detyrimeve (LMD), është e paraparë se *“pjesëmarrësit e detyrimit kanë për detyrë që ta zbatojnë detyrimin e vet dhe janë përgjegjës për përmbushjen e tij”*, ndërsa me nenin 262 të po këtij ligji, është paraparë se *“kreditore në raportin e obliguar është i autorizuar që prej debitorit të kërkojë përmbushjen e detyrimit, ndërsa debitori ka për detyrë ta përmbush me ndërgjegje krejtësisht sikundër është përmbajtja e tij”*. Po ashtu me nenin 371 të Ligjit për marrëdhëniet e detyrimeve parashihet se *“Kërkesat parashkruhen në pesë vjet, në qoftë se me ligj nuk është caktuar ndonjë afat tjetër i parashkrimit”*. Ndërsa sipas dispozitave të nenit 378 par.1 të Ligjit për marrëdhëniet e detyrimeve parashihet se parashkruhen për një vjet:

*“- a) kërkesat e kompenzimit për livrimin e energjisë elektrike e të ngrohjes, ujit, gazit dhe shërbimet e pastrimit të oxhaqeve dhe për mirëmbajtjen e pastërtisë, kur livrimi respektivisht shërbimi është kryer për nevoja shtëpiake...”*

Në bazë të gjendjes faktike të vërtetuar dhe provave të administruara në këtë çështje kontestimore, gjykata ka ardhur në përfundim se, kërkesëpadia e paditësit duhet të aprovohet në tërësi. Kjo ngase në bazë të provave të administruara del se ky borxh evidentohet në emër të të paditurit S.K gjegjësisht është provuar se këtu i padituri ka detyrime-borxh, ndaj paditësit Hidroregjioni Jugor - Prizren për shfrytëzimin e shërbimeve të ujësjellësit dhe kanalizimit për periudhën 01.04.2003 deri më 30.09.2005, andaj dhe vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Gjykata nuk i pranoi pretendimet e të autorizuarit të të paditurit se në rastin konkret është parashkruar borxhi sepse shuma e fundit e borxhit është e datës 30.11.2004 ndërsa padia është parashtruar me datë 28.03.2006 që do të thotë se borxhi është parashkruar dhe se i padituri e ka likuiduar në tërësi borxhin, pasi që gjykata ka vlerësuar se borxhi ka arritur për pagesë me datën 31.05.2003, e që në rastin konkret nuk ka kaluar afati për parashkrimin e kërkesave, i paraparë sipas dispozitave të LMD-së, pasi që paditësi (ish kreditore) propozimin për ekzekutim e ka dorëzuar në gjykatë me datën 28.03.2006, që do të thotë se borxhi i të paditurit nuk hyn në grupin e kërkesave që parashkruhen në afat prej një viti, sepse i padituri si konsumator nuk ka shfrytëzuar ujin për nevoja shtëpiake por ka qenë në kategorinë e lokaleve-bizneseve. Po ashtu i padituri ka bërë pagesën e një shume të borxhit me datën 01.04.2005 dhe 31.05.2005 ( kjo është vërtetuar në bazë të kartelës së klientit-të paditurit S.K ). Ndërsa sa i përket pretendimeve se borxhi është likuiduar në tërësi të njëjtat nuk qëndrojnë sepse në bazë të provave të administruara është vërtetuar se i padituri ka bërë pagesën e borxhit pas datës 30.11.2005 (datë pasi që lënda është dërguar në gjykatë dhe ka filluar që të llogaritet borxhi nga fillimi) e deri në datën 18.01.2013, kur është bërë ç'kyqja nga rrjeti i ujësjellësit, ndërsa borxhi prej 376.02 eurove është para datës 30.11.2005 dhe i njëjti borxh nuk i është llogaritur pas kësaj date (i njëjti borxh ka ekzistuar dhe nuk është paguar) pasi që lënda ka qenë në gjykatë me padi.

Vendimin mbi shpenzimet procedurale gjykata e mori konform nenit 449 dhe 452.1 të LPK-së, dhe vendosi që i padituri t'ia paguajë paditësit shumën prej 25 €, në emër të taksës gjyqësore.

Gjykata gjithashtu ka vlerësuar edhe provat dhe theksimet e tjera të palëve ndërgjyqëse, por ka gjetur se të njëjtat janë pa ndikim në nxjerrjen e këtij aktgjykimi

Nga të lartcekurat u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, e konform nenit 143 të LPK-së.

**GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN**  
**C.nr.793/06, datë 25.03.2014**

Sekretarja juridike  
Majlinda Shala

**Gjyqtari**  
**Arsim Hamzaj**

**KËSHILLA JURIDIKE:** Kundër këtij aktgjykimi pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në afat prej 7 ditësh pas ditës së pranimit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, nëpërmjet të kësaj gjykate.

Aktgjykimi mund të goditet vetëm për shkak të shkeljes esenciale të dispozitave mbi procedurën kontestimore dhe për shkak të zbatimit të gabuar të së drejtës materiale.